




Republika e Kosovës/
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Anketa e Mbeturinave Komunale 2019



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Anketa e Mbeturinave Komunale 2019



Botuesi : Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit : Nëntor 2020

© Agjencia e Statistikave të Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata më të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mundë të qasenë përmes web-faqes së ASK- së.

Web-faqe: <http://ask.rks-gov.net/> dhe

Tel.+381(0) 200 31-120

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e Anketës së Mbeturinave Komunale (AMK) për vitin referues 2019, si anketë e rregullt vjetore

Qëllimi i kësaj ankete është që të siguroj të dhëna statistikore të qëndrueshme për sektorin e mbeturinave komunale në Kosovë. Rezultatet e prezantuara në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm statistikor për gjendjen e tanishme të këtij sektori.

Metodologjia e përdorur për realizimin e anketës është në harmoni me rregulloret dhe rekomandimet e BE-së, duke përfshirë edhe Ligjin e Mbeturinave në Kosovë 2005/02/L-30 dhe 2011/04-L-060.

Publikimi është përgatitur nga:

Bajrush Qevani, Drejtor DSBM
Haki Kurti, Shef Divizioni i Statistikave të Mjedisit
Flutura Shosholli, Zyrtare e Statistikave të Mjedisit

Sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe të dërgohen në:

E- mail: agricultural@ks-gov.net

Nëntor, 2020

Zv. Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së

Ilir T. Berisha

Shkurtesat dhe Simbolet

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KKP	Kompanitë Komunale Publike
DSBM	Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
DS	Deponitë sanitare

Simbolet

kg-	Kilogram
t-	Ton
kg/v-	Kilogram në vit
kg/d-	Kilogram në ditë
%-	Përqindje

P ë r m b a j t j a

Objektivat, metodologjia e anketës.....	5
Metodologjia.....	5
Procedurat në terren.....	5
Definicioni.....	6
Rezultatet.....	7
Tabela 1.....	7
Tabela 2.....	8
Tabela.3.....	9
Tabela 4.....	10
Aneksi 1 Pyetësori.....	12

1. Objektivat, metodologjia e anketës

1.1 Objektivat

Objektivi i anketës së mbeturinave komunale 2019, ka qenë që të sigurojë të dhëna statistikore për mbeturinat komunale për:

- Gjenerimin e mbeturinave komunale dhe
- Trajtimi i mbeturinave komunale

Gjithashtu ka pasur për qëllim që të siguroj bazën e monitorimit të mbeturinave komunale në të ardhmen në këtë sektor.

1.2 Metodologjia

1.2.1 Korniza e anketës

Në Qershor 2020 janë bërë të gjitha përgatitjet metodologjike për realizimin e AMK 2019 si vijon:

- Nga regjistri i bizneseve është nxjerrur lista e bizneseve, përgatitja e pyetësorit, udhëzuesit dhe mostra e anketës.
- Mostra e AMK 2019 është përbërë prej 35 bizneseve, ndërsa numri i bizneseve që janë përgjigjur në anketë ka qenë 25 (duke përfshirë dhe kompanitë regjionale për menaxhimin e mbeturinave).

1.2.2 Procedurat në terren

Puna në terren u krye gjatë periudhës kohore korrik-gusht 2020, nga anketuesit të cilët zhvilluan intervista të drejtpërdrejta me menaxherët e kompanive, në bazë të pyetësorëve. (Shtojca 1).

Gjithashtu gjatë periudhës së lartpërmendur janë zhvilluar edhe aktivitete si në vijim:

- Mbikëqyrja dhe kontrollimi i pyetësorëve të plotësuar në terren nga mbikëqyrësi.

- Kontrollimi cilësor i pyetësorëve të plotësuar në zyrën qendrore në ASK (stafi i Divizionit të Statistikave të Mjedisit).

2. Definicioni

Mbeturinat Komonale - janë mbeturina nga amvisëritë, po ashtu edhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

3. REZULTATET E ANKETËS SË MBETURINAVE KOMUNALE 2019

Tabela 1: Mbeturinat komunale të grumbulluara në vitin 2019

Vendi i grumbullimit	Sasia e grumbulluar	Popullsia ¹	Mbeturina të grumbulluara	
			kg/banorë/vit	kg/banorë/ditë
Njësia	1000/ton			
Prishtina dhe regjioni ²	139	492.488	282	0,77
Regjionet tjera	313	1.289.627	242	0,66
Gjithsej Kosova	452	1.782.115	253	0,69

Në Kosovë në vitin 2019 janë grumbulluar gjithsej 452 mijë ton mbeturina komunale.

Të dhënat e vitit 2019 tregojnë se mesatarja e mbeturinave komunale të grumbulluara në Kosovë ka qenë 253, kg për banorë në vit. Ndersa mesatarja e mbeturinave të grumbulluara për banorë në ditë 0.69 kg.

Në Prishtinë dhe regjionin e sajë grumbullimi i mbeturinave komunale ka qenë 0.77, kg në ditë për banorë.

Në regjionet tjera të Kosovës sasia e mbeturinave komunale të gjeneruara për banorë në ditë ka qenë 0.66, kg/banorë/ditë (shiko tabelën 1).

Në vitin 2019, shkalla e mbulueshmërisë së ekonomive familjare (nga sistemi i grumbullimit të mbeturinave komunale) kanë qenë 76 %.

¹

ASK, Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës 2019 (31 dhjetor 2019).

²

Prishtina, Obiliqi, Gllogoci, Fushë Kosova, Lipjani, Graçanica, Podujeva.

Tabela 2. Mbeturinat e grumbulluara sipas regjioneve për vitet 2012-2019, t/, kg banorë/vit, kg/banorë/ditë.

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Njësia	në 1000 ton							
Prishtina dhe regjioni	249	255	95	105	105	115	110	139
Regjionet tjera	358	320	152	214	289	294	297	313
Kosova gjithsej	607	575	247	319	395	409	407	452
Njësia	në kg/banorë,v							
Prishtina dhe regjioni	515	517	193	214	221	235	223	282
Regjionet tjera	269	242	119	163	224	225	228	242
Kosova gjithsej	334	317	140	177	223	228	227	253
Njësia	në kg/banorë,d							
Prishtina dhe regjioni	1,41	1,41	0,50	0,60	0,60	0,60	0,61	0,77
Regjionet tjera	0,70	0,66	0,30	0,50	0,61	0,61	0,62	0,66
Kosova gjithsej	0,90	0,86	0,40	0,50	0,61	0,61	0,62	0,69

Gjithsej sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara për vitin 2019 ka qenë për 11% më e lartë krahasuar me vitin 2018.

Gjithashtu sasia mbeturinave komunale të grumbulluara për banorë në vitin 2019, ka qenë për 11% më e lartë krahasuar me vitin 2018.

Grafiku 1. Grumbullimi i mbeturinave komunale sipas regjioneve sipas vitet 2012-2019 (1000t).




Tabela 3. Mbeturinat komunale të grumbulluara sipas regjioneve për vitin 2019.

Vendi i grumbullimit	Sasia e grumbulluar 1000/t	Popullsia	Mbeturina të grumbulluara	
			kg/banorë/vit	kg/banorë/ditë
Prishtina	139	492.488	282	0,77
Ferizaj	39	183.250	213	0,58
Gjakovë	34	198.762	172	0,47
Gjilan	37	159.813	231	0,63
Mitrovicë	71	222.472	319	0,87
Pejë	54	179.141	300	0,82
Prizren	78	346.189	225	0,62
Gjithsej Kosova	452	1.782.115	253	0,69

Në tabelën 3, janë paraqitur të dhënat vjetore të mbeturinave komunale të grumbulluara sipas regjioneve, me ç'rast vërehet se sasia më e madhe e mbeturinave të grumbulluara është në Regjionin e Prishtinës, 139 mijë t/vit, ndërsa sasi më e vogël e mbeturinave të grumbulluara vërehet në Regjionin e Gjakovës, 34 mijë t/vit.



Grafiku 2: Grumbullimi i mbeturinave komunale sipas regjioneve për vitin 2019, t/vit.

Tabela 4: Mbeturinat komunale të deponuara në deponitë e licencuara për vitin 2019.

Deponitë	2019
	1000/t
DS/ Prishtinë	151
DS/ Ferizaj	25
DS/ Gjilan	42
DS/ Mitrovicë	54
DS/ Pejë	54
DS/ Prizren	104
DS/ Podujevë	16
Gjithsej	446

Të dhënat e deponive tregojnë se në vitin 2019, në deponin e Mirashit në Prishtinë, ka pasur sasi më të madhe të mbeturinave të deponuara, 151 mijë ton në vitë, ndërsa saisa më e vogël e mbeturinave të deponuara ka qenë në deponin e Podujevës me vetëm 16 mijë ton mbeturina të deponuara në vit.Ndërsa gjithsej sasia e mbeturinave të deponuara në deponit sanitare ka qenë 446 mijë ton. Gjithsej sasia e mbeturinave të deponuara për vitin 2019, ka qenë për 5% më e lartë krahasuar me vitin 2018.

Grafiku 3: Mbeturinat komunale të grumbulluara në deponitë e Kosovës në vitin 2019.



Aneks 1 Pyetësoni

Agjencia e Statistikave të Kosovës përshkrim i shkurtër

Agjencia e Statistikave të Kosovës, është institucion profesional, i cili vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe. Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili kua hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Misioni i Agjencionit, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

Adresa: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Rr. "Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë

Telefonat: +381 (0) 31 129

Kryeshefi ekzekutiv : +381 (0) 38 200 31 112

Fax: +381 (0) 38 235 033

E-mail: infoask@rks-gov.net

Ueb-faqe: <http://ask.rks-gov.net/>